



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 895 prot.

Tiranë, më 27.03.2026

REKOMANDIM

Nr. 18, datë 27.03.2026

**PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS
TË AUTORITETIT PUBLIK URDHRI I PSIKOLOGUT**

Në mbështetje të neneve 4, 6, 7, si dhe shkronjës f) të pikës 2 të nenit 9/1 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim LDI),

KONSTATOVA SE:

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) është përgjegjëse për monitorimin dhe mbikëqyrjen e transparencës proaktive të autoriteteve publike. Në përmbushje të këtij detyrimi ligjor, vlerësohet se institucionet e sistemit shëndetësor publik luajnë një rol thelbësor në organizimin, funksionimin dhe garantimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, duke përbërë një kategori të rëndësishme të autoriteteve publike.

Në nenin 1 të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” përcaktohet se: “Me ent publik për qëllimet e këtij ligji do të kuptohet çdo subjekt i së drejtës publike joshtetëror, i krijuar me ligj dhe që synon realizimin e një interesi publik”.

Nëpërmjet ligjit nr.40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar është krijuar dhe funksionon Urdhri i Psikologut, si ent publik jobuxhetor, i pavarur, i cili ka si qëllim nxitjen dhe ruajtjen e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesionit në fushën e psikologjisë, si dhe mbrojtjen e përfituesve të shërbimit nga kequshtrimi i profesionit të psikologut.

Në pikën 1 të nenit 2 të LDI përcaktohet se: “Autoritet publik” a) është çdo organ publik, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisive të

qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës “c” të kësaj pike”.

Për sa më sipër, Urdhri i Psikologut konsiderohet autoritet publik, në kuptim të LDI.

Autoritetet publike, bazuar në pikën 1 të nenit 4 të LDI, kanë detyrimin të vënë në zbatim programin institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publike pa kërkesë, si dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni. Gjithashtu, në pikat 2 dhe 3 të këtij neni përcaktohet se:

“2. Në përgatitjen e projektprogramit të transparencës, autoriteti publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos:

- a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;*
- b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;*
- c) modelet e miratuara për kategorinë e autoritetit publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.*

3. Programi i transparencës bëhet publik në faqen zyrtare në internet të autoritetit publik”.

Programi i Transparencës vlerësohet si instrument konkret, përmes të cilit, autoriteti publik ndërton dhe rrit transparencën institucionale, nëpërmjet publikimit dhe përditësimit të vazhdueshëm me informacion në rubrikat e tij.

Në nenin 6 të LDI parashikohet se: *“Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi...”.*

Në zbatim të shkronjës c) të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 6 të LDI, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka miratuar Urdhrin nr. 280, datë 30.12.2025 *“Për miratimin e Programit model të Transparencës për autoritetet publike”* (në vijim *“Urdhri nr. 280/2025”*), publikuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 6, datë. 08.01.2026.

Në nenin 5 të LDI përcaktohet se: *“Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas të njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij. Afatet për rishikimin e programit të transparencës mund të ndryshojnë në varësi të natyrës së çdo autoriteti publik, por, në asnjë rast, nuk mund të jenë më të gjata se 5 vjet”.*

Për sa më sipër, autoriteti publik ka detyrimin të vendosë në zbatim Programin institucional të Transparencës, sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, referuar pikës 1 të nenit 7 të LDI dhe Urdhrit nr. 280/2025, në të cilin përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publike pa kërkesë.

Në kuadër të zbatimit të detyrimeve ligjore të mësipërme, Zyra e Komisionerit ka kryer monitorimin online në faqen zyrtare në internet të autoritetit publik. Pas monitorimit, Zyra e Komisionerit ka konstatuar se autoriteti publik nuk ka publikuar Programin e Transparencës, në përputhje me përmbajtjen e miratuar me Urdhrin nr. 280/2025. Gjithashtu, Zyra e Komisionerit konstatoi se një pjesë e rubrikave të Programit të Transparencës janë plotësuar/përditësuar me informacion. Por rezultojnë disa rubrika, të cilat nuk janë plotësuar/përditësuar me informacion, konkretisht:

Rreth autoritetit

- Struktura organizative/Organigrama;
- Struktura e pagave;
- Procedura që ndjekin funksionarët e lartë të AP për të marrë vendime;
- Vendimmarrja e AP;

Shënim: Nëse Autoriteti Publik nuk disponon informacionin, të vendoset shënimi (nuk ka informacion) në krahasim të çdo pike.

Kuadri ligjor rregullator dhe integrimi evropian

- Informacion mbi procesin e integritit evropian;
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit;

Shënim: Nëse Autoriteti Publik nuk disponon informacionin, të vendoset shënimi (nuk ka informacion) në krahasim të çdo pike.

Shënim: Nëse Autoriteti Publik nuk disponon informacionin, të vendoset shënimi (nuk ka informacion) në krahasim të çdo pike.

Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncensionit/partneritetit publik privat

- Lista e kontratave të lidhura (përfshirë shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve)
- Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik;
- Regjistri i realizimeve të prokurimit publik;
- Informacion mbi zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme.

Shënim: Nëse Autoriteti Publik nuk disponon informacionin, të vendoset shënimi (nuk ka informacion) në krahasim të çdo pike.

Shërbimet që ofrohen nga AP

- Lista e Shërbimeve që ofron AP, përfshirë (formular aplikimi, afati kohor, procedurë ankimimi, standardet për cilësinë e shërbimit)

Shënim: Të vendoset shënimi nëse AP nuk ofron shërbime.

Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve

- Lista e dokumenteve që administrohen nga AP me afatet e ruajtjes
- Formën e dokumenteve/informacioneve (elektronik, kopje fizike, audio, video, foto)

Nga ana tjetër, pika 1 e nenit 10 të LDI, përcakton se: *“1. Titullari i autoritetit publik cakton një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit. Menjëherë pas caktimit ose ndryshimit të koordinatorit për të drejtën e informimit, titullari i autoritetit publik i njofton Komisionerit emrin dhe kontaktet e nëpunësit”.*

Nga monitorimi i kryer, Zyra e Komisionerit konstatoi se autoriteti publik ka publikuar të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit në faqen zyrtare në internet.

Në pikën 1 të nenit 8 të LDI parashikohet se: *“Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. **Ky regjistër përditësohet jo më pak se 1 (një) herë në muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuësve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër”.***

E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon të drejtën e qytetarëve për të patur akses në dokumente zyrtare dhe detyrimin e autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë. Nga ana tjetër, Programi model i Transparencës dhe Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve përfaqësojnë instrumentet kryesore të promovimit të transparencës proaktive të autoriteteve publike dhe garantimit të së drejtës për informim të publikut, si rrjedhojë çdo autoritet publik ka detyrimin ligjor për vënien në zbatim dhe përditësimin e vazhdueshëm me informacion të tyre.

Në lidhjen (<https://idp.al/ap25/>) do të gjeni formatin e dokumentit për zbatim nga ana juaj, konkretisht Urdhrin nr. 280/2025.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7, 8, shkronjës f) të pikës 2 të nenit 9/1, shkronjës b) të pikës 2 të nenit 10 dhe pikës 1 të nenit 24/1 të LDI,

REKOMANDOJ:

1. Autoriteti publik Urdhri i Psikologut të përditësojë dhe të ndërlidhë në programin e transparencës të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshme për t’u bërë publike, në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, i ndryshuar dhe Urdhrin nr. 280, datë 30.12.2025 *“Për miratimin e Programit model të*

Transparencës për autoritetet publike” të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

2. Koordinatorin për të drejtën e informimit pranë autoritetit publik Urdhri i Psikologut të përditësojë jo më pak se 1 (një) herë në muaj Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, në përmbushje të detyrimeve të shkronjës b) të pikës 2 të nenit 10 dhe në zbatim të pikës 1 të nenit 8 të ligjit nr. 119/2014 “*Për të drejtën e informimit*”, të ndryshuar.
3. Në zbatim të pikës 1 të nenit 24/1 të ligjit nr. 119/2014 “*Për të drejtën e informimit*”, të ndryshuar, detyrimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij Rekomandimi, të plotësohen brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni.
4. Në rast mospërmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas neneve 18 dhe 19 të ligjit nr. 119/2014 “*Për të drejtën e informimit*”, i ndryshuar.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 27.03.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi